



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Veriore
Opština Severna Mitrovica – Municipality of Mitrovica North

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS VERIORE

Nr. _____, Data: 31/01/2025.

Mitrovicë Veriore.

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA MITROVICA E VERIUT - OPŠTINA SEVERNA MITROVICA	
MITROVICA NORTH MUNICIPALITY	
Njesia Org. Org. Jedin. Org. Unit.	10
Nr. Prot. Sr. Prot. Prot. No.	12-03d/01-0001252/25
Nr. i fjalëve Br. stranice No. pages	4
Data Datum Date	31/01/2025

RREGULLORE KOMUNALE NR. 04/2025
PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE

Janar 2025, Mitrovicë Veriore

Në pajtim me dispozitat e nenit 2 dhe 7 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve nr. 02/L-37, UA (MAPL) Nr. 01/2022 Për Përcaktimin e Procedurave për zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në Komuna data 17.10.2022, të dispozitave të nenit 9 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040 dhe të dispozitave të nenit 13, paragrafi 1, pika 1.3 të Statutit të Komunës së Mitrovicës Veriore Nr. 10-030/01-0007269/24 të datës 28.06.2024, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës Veriore, në mbledhjen e mbajtur më 31/01/2025, miratoi këtë:

RREGULLORE KOMUNALE NR. 07/2024 PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim rregullimin e përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe gjuhëve në përdorim zyrtar në organet e Komunës së Mitrovicës Veriore (më tutje Komuna), institucionet arsimore, institucionet e shëndetësisë dhe ndërmarrjet publike lokale dhe të gjitha institucionet të cilat janë në kuadër dhe në përgjegjësi të Komunës. Të vendosë për procedurat përmes të cilave Kuvendi i Komunës, njeh gjuhët tjera zyrtare dhe gjuhët në përdorim zyrtar në Komunë, të ofrojë udhëzime mbi mënyrën me të cilën përfaqësuesit komunalë, organet e administratës dhe ndërmarrjet publike lokale, do t'i përmbushin obligimet e tyre në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe gjuhëve në përdorim zyrtar në Komunë.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo rregullore fushëveprimin e ka në të gjitha organet e Komunës dhe në të gjitha ndërmarrjet publike lokale të kësaj Komune.

Neni 3

Gjuhët Zyrtare

Gjuha shqipe dhe gjuha serbe dhe alfabetet e tyre, janë gjuhë zyrtare në Komunë.

Neni 4

Gjuhët në Përdorim Zyrtar

1. Në nivelin komunal, gjuhët e tjera të bashkësive, si gjuha turke, boshnjake dhe rome, do të jenë gjuhë në përdorim zyrtar, sipas kushteve të përcaktuara me ligj.
2. Gjuha e një komuniteti, i cili sipas rezultateve të publikuara të regjistrimit të popullsisë, përbën 5% ose më tepër të popullatës brenda territorit të Komunës, Kuvendi i Komunës me vendim do ta njeh si gjuhë zyrtare në Komunë.
3. Gjuha e një komuniteti, i cili sipas rezultateve të publikuara të regjistrimit të popullsisë, përbën 3% deri në 5% të popullsisë brenda territorit të Komunës, njihet si gjuhë në përdorim zyrtar në Komunë me vendim të Kuvendit të Komunës.
4. Gjuha e folur me traditë në Komunë mund të njihet si gjuhë në përdorim zyrtar me vendim të Kuvendit të Komunës.
5. Njohja e gjuhëve në përdorim zyrtar nga pika 3 dhe 4 e këtij neni bëhet në pajtim me kriteret dhe procedurat e parapara me ligj dhe akte tjera nënligjore.

Neni 5

Zyra për përkthime

1. Drejtoria e Administratës formon dhe siguron funksionimin e Zyrës së përkthimit. Zyrja e përkthimit përbehet nga përkthyesit dhe lektorët, të cilët për punën e tyre, i raportojnë Drejtorisë së Administratës, Udhëheqësit të sektorit për punë përbashkëta.
2. Drejtoria e Administratës bën vlerësime periodike të numrit të përkthyesve të nevojshëm për të bërë shërbimet e përkthimit në gjuhët zyrtare dhe gjuhët në përdorim zyrtar në Komunë.

2. Drejtoria e Administratës bën vlerësime periodike të numrit të përkthyesve të nevojshëm për të bërë shërbimet e përkthimit në gjuhët zyrtare dhe gjuhët në përdorim zyrtar në Komunë.
3. Drejtoria e Administratës planifikon dhe kërkon burime buxhetore komunale për të siguruar rekrutimin, trajnimin dhe zhvillimin profesional të stafit të Zyrës së përkthimit. Drejtoria e Administratës siguron zyrë adekuate, pajisje dhe material hargjues për Zyrën e përkthimit.
4. Kërkesa për rishikim të akteve administrative ose lëshimeve që kanë të bëjnë me respektimin e gjuhëve zyrtare nga Komuna e Mitrovicës Veriore, duhet të adresohen te Drejtoria e Administratës përkatësisht tek Zyrja e përkthimeve.
5. Drejtoria e Administratës, në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm për Shërbimin Civil të Kosovës, nxjerr përshkrimin e punëve, sqaron përgjegjësitë dhe vlerëson performancën e stafit të Zyrës së përkthimit.

Neni 6

Shërbimet dhe dokumentet në gjuhën zyrtare

1. Përfaqësuesit komunal, institucionet komunale, të arsimit, të shëndetësisë dhe ndërmarrjet publike lokale sigurojnë që secili qytetar mund të komunikojë verbalisht me zyrtarët komunal dhe të pranojë shërbimet dhe dokumentet publike në gjuhët zyrtare. Për ta ushtruar këtë të drejtë, ata duhet të paraqesin kërkesë verbale ose me shkrim. Drejtoria e Administratës harton procedura për të pranuar dhe plotësuar këto kërkesa përmes njësisë së përkthimit dhe mundësisë për përkthim simultan.
2. Kryesuesit, drejtorët e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive dhe ata të ndërmarrjeve publike komunale, sigurojnë që shenjat që përmbajnë emërtimet zyrtare të institucioneve të tyre të jenë të shkruara në të gjitha gjuhët zyrtare të Komunës dhe të vendosura në vende publike.
3. Drejtoria e Shërbimeve Publike siguron që brenda territorit të Komunës dhe në rrugët lokale, të gjitha shenjat që tregojnë apo përmbajnë emrat e Komunave, fshatrave, rrugëve apo vendeve të tjera publike, të jenë të shkruara në të gjitha gjuhët zyrtare të Komunës dhe të vendosura në vend publik.

Neni 7

Procedurat për të kërkuar shërbime dhe dokumente në gjuhën në përdorim zyrtar

1. Kërkesa për shërbime dhe dokumente ose për përkthime të rregulloreve komunale dhe akteve tjera në një gjuhë në përdorim zyrtar, duhet të dërgohen tek përfaqësuesit përgjegjës komunalë, organi ekzekutiv ose ndërmarrja publike lokale.
2. Nëse institucionet që janë në përgjegjësi të Komunës, dështojnë që të sigurojnë shërbimin, përgjigjen ose dokumentin në gjuhën në përdorim zyrtar, kërkuesi mund të parashtrojë kërkesë në Komunë.
3. Komuna siguron që brenda 15 ditëve të punës këto kërkesa, shërbime dhe dokumente të jenë të gatshme për kërkuuesin gjuha e të cilit është në përdorim zyrtar.

Neni 8

Shërbimi i përkthimit për anëtarët e organeve përfaqësuese/ekzekutive komunale

Gjatë mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij, anëtarët e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive komunale, gjuha e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare e Komunës, mund të paraqesin kërkesë për shërbime të përkthimit (në formë verbale dhe të shkruar) në Drejtorinë e Administratës, e cila duhet të sigurojë përmbushjen e saj përmes njësisë së përkthimit.

Neni 9

Mbikëqyrja

1. Drejtori i Administratës është personi përgjegjës për zbatimin e përdorimit të gjuhëve zyrtare në Komunë.
2. Drejtori i Administratës, në bashkëpunim me drejtorët e organeve ekzekutive komunale dhe të ndërmarrjeve publike komunale, organizon teste vullnetare për të vlerësuar aftësitë gjuhësore

të shërbyesve civilë, kurse vullnetare të gjuhës për të ngritur nivelin profesional të shërbyesve civil të secilës gjuhë zyrtare dhe gjuhëve në përdorim zyrtar në Komunë. Personi kryesor për gjuhë specifikon burimet e nevojshme financiare për mbarëvajtjen e testeve gjuhësore dhe kurseve, dhe kërkon nga Kuvendi i Komunës alokimin e tyre te Drejtoria e Administratës.

3. Personi përgjegjës për zbatimin e përdorimit të gjuhëve zyrtare në Komunë, përgatit raport vjetor mbi zbatimin e kësaj Rregullore komunale dhe të Ligjit për përdorimin e gjuhëve nga ana e Komunës. Raporti i dorëzohet Kryetarit të Komunës, Kuvendit dhe Komitetit për komunitete.
4. Kuvendi i Komunës rishikon dhe miraton raportin bazuar në rekomandimet e Komitetit për komunitete.
5. Kryetari dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës sigurojnë që raporti të publikohet dhe të postohet në ueb-faqen e Komunës, në të gjitha gjuhët zyrtare dhe në gjuhët në përdorim zyrtar në Komunë.

Neni 10

Informimi Publik

Kryetari dhe Drejtori i Administratës, organizojnë veprimtari të rregullta informuese për publikun mbi të drejtat, procedurat dhe obligimet që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve dhe të kësaj Rregullore komunale. Veprimtaritë informuese publike bëhen në gjuhët zyrtare dhe në gjuhët në përdorim zyrtar në Komunë.

Neni 11

E drejta e ankesës

1. Çdo person i cili beson se atij i është shkelur e drejta për përdorimin e gjuhës zyrtare, ka të drejte të parashtojë ankesë tek Kryetari i Komunës.
2. Për pjestarët e komunitetit gjuha e të cilëve është në përdorim zyrtar pasi të kenë vepruar sipas procedurave të cekura në nenin 7 të kësaj rregullore, mund të parashtojnë ankesë tek Kryetari i Komunës.
3. Nëse Kryetari nuk përgjigjet në ankesë atëherë ankesa duhet të drejtohet në Zyren e Komisionerit për gjuhët.

Neni 12

Dispozitat Kalimtare dhe të Fundit

1. Kjo Rregullore mund të plotësohet apo ndryshohet në procedurë të njëjtë me atë të miratimit.
2. Kjo Rregullore nxirret në gjuhët zyrtare të Komunës gjuhën shqipe dhe serbe.
3. Në rast të mospajtimeve mes dispozitave të kësaj Rregulloreje do të mbizotërojnë dispozitat e Ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe UA (MAPL) Nr. 01/2022 Për Përcaktimin e Procedurave për zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në Komuna dt. 17.10.2022.
4. Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pune pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse si dhe pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Veriut.

Mitrovicë Veriore

Nedžad UGLJANIN

Kryesues i Kuvendit në Komunën e Mitrovicës Veriore

Dorëzohet:

1x1 Kryesuesit të Kuvendit

1x1 MAPL

1x1 Arkivit

**Kopje: Kryetarit të Komunës
Të gjitha Drejtorive**



Zyra e Kyeministrit/Zyra e Komisionerit për gjuhët, ka marrë një shkresë nga MAPL, me datën 06.02.2025, me nr. prot. 146, në bazë të së cilës është kërkuar shqyrtimi i ligjshmërisë së Rregullores Komunale Nr.04/2025 për Përdorimin e Gjuhëve në Komunën e Mitrovicës së Veriut.

Duke u bazuar në Rregullore nr. 07/2012 për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët, (neni25), Zyra ka analizuar dhe ka shqyrtuar rregulloren e komunës në detaje, duke u bazuar në Ligjin Nr. 02/L-37 Për Përdorimin e Gjuhëve dhe konstaton se Rregullorja komunale Nr.04/2025 për përdorimin e gjuhëve në Komunën e Mitrovicës së Veriut, është në përputhshmëri me Ligjin për përdorimin e gjuhëve.

Gjithnjë duke u bazuar në Ligj dhe për të qenë më qartë, sugjerojmë se neni 3 i kësaj rregulloreje të jetë kështu:

Neni 3
Gjuhët zyrtare

Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe edhe alfabetit e tyre janë gjuhë zyrtare në Komunë.

Neni 4
Gjuhët në përdorim zyrtar

1. Në nivelin komunal, gjuhët e tjera të bashkësive, si gjuha turke, boshnjake dhe rome, do të jenë gjuhë në përdorim zyrtar, sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

Pasojnë paragrafët ekzistues në rregullore, të cilët kanë dhënë sqarime të duhura kur një gjuhë mund të fitojë statusin e gjuhës zyrtare apo statusin e gjuhës në përdorim zyrtar,

Me respekt,
Zyra e Komisionerit për Gjuhët